

Creative Encounters Tirana

Programi:

Dita I - 28 Janar 2024

Vendodhja: Piramida

- Ora 10:00 Përshëndetje dhe fjalë hapëse:
 - Shkëlqesia e Tij z. Alastair King-Smith, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri
 - Z. Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
 - Z. Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë Tiranë
 - Znj. Clare Sears, Drejtor i British Council për Ballkanin Perëndimor
- Ora 11:00 - Nënshkrimi zyrtar i Memorandiumit të Mirëkuptimit ndërmjet British Council dhe Bashkisë Tiranë
- Ora 11:15 Prezantimi i konferencës
Z. Jonid Jorgji, Drejtor i Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë
- Ora 11:30 – 14:30 **Përcaktimi i rekomandimeve të politikave dhe praktikave prioritare**

Panele diskutimi dhe Grupet e punës sektoriale

Panelet i kushtohen katër fushave prioritare të industrive kreative; Infrastruktura e re Kulturore, City Branding - Integrimi i identiteteve të reja në markën e qytetit, Eventet e mëdha kulturore dhe ndikimi i tyre në qytet, Qyteti si destinacion filmi

Pjesa e parë e secilit grup pune do të prezantojë disa shembuj dhe praktikave në Shqipëri, rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Mbretërinë e Bashkuar (MB). Në pjesën e dytë të këtyre seancave, të gjithë pjesëmarrësit e konferencës do të marrin pjesë aktive dhe do të punojnë së bashku në identifikimin e tetë deri në dhjetë prioriteteve strategjike për secilin sektor të industrisë kreative, të cilat do të prezantohen në ditën e dytë të konferencës.

➤ **Grupi i punës 1: Infrastruktura e re kulturore**

Me zhvillimet e reja në shoqëritë dhe teknologjinë tonë, kultura ka nevojë për infrastrukturë të re dhe modele të reja ekonomike mbi të cilat ato operojnë. Ashtu si qytetet në Britaninë e Madhe, qyteti i

Tiranës investoi dhe po planifikon të investojë në hapësira të reja për kulturën. Për t'i bërë ato të suksesshme, këto vende duhet të pasqyrojnë nevojat e komunitetit. Ky grup pune do të hetojë disa nga modelet ekzistuese në Shqipëri dhe MB.

Moderator: John Newbiggin OBE (PEC/City of London)

Ekspert: Keti Luarasi (Bashkia Tiranë)

Diana Xhumari

Lorena Gjana

Arlind Haxhiaj

Andy Brydon (Curated Place, UK),

Adele Patrick (Art School Plus)

➤ **Grupi i punës 2: City Branding - Integrimi i identiteteve të reja në markën e qytetit**

Teksa qytetet po ndryshojnë me shpejtësi, ato po bëhen shtëpi e shumë identiteteve të reja. Identitetet e reja janë shpesh një atraksion për turistët ose qytetarët e ardhshëm, të cilët po kërkojnë mënyra për të realizuar karrierën e tyre. Në vitet e kaluara, Tirana u bë një atraksion për shumë artistë dhe krijues në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Krahas historisë së pasur, qyteti i Tiranës synon të komunikojë krijimtarinë dhe shpirtin e saj modern. Si mund të kontribuojë sektori krijues në këtë nismë? Cilat janë mundësitë dhe pengesat në tërheqjen e audiencave të reja? Si të përmirësohet zhvillimi i turizmit kulturor? Ky grup pune do të ofrojë disa përgjigje për këto pyetje.

Moderator: Rehana Mughal (British Council)

Ekspert: Sonila Abdalli

Saimir Kristo

Jonid Jorgji

Kate Wyatt (Curated Place)

Melanie Iredale (Reclaim the Frame)

➤ **Grupi i punës 3: Eventet e mëdha kulturore dhe ndikimi i tyre në qytet**

Evente të mëdha kulturore si festivalet muzikore dhe koncertet e mëdha janë elementë të pashmangshëm në jetën e përditshme të qyteteve. Përveçse janë një përvojë e shkëlqyer për audiencën, këto evente janë gjithashtu një mënyrë për të kontribuar në ekonominë e qytetit duke sjellë një numër të madh vizitorësh që përdorin shërbime të shumta në terren. Në vitet dhe muajt e ardhshëm, Tirana synon të profilizohet si një destinacion i rregullt për artistët inovatorë dhe yjet botërorë. Ky grup pune synon të identifikojë strategjinë dhe hapat e nevojshëm për të siguruar pozicionin e qytetit në këtë fushë.

Moderator: Iris Canaj

Ekspert: Rubin Beqo

Ajola Xoxa

Aleksandër Cifligu

Artemis Zoga

Chris Bailkoski (Soup, Manchester, UK),
Edin Zupčević (Gramofon, Bosnia and Herzegovina)

➤ **Grupi i punës 4: Qyteti si destinacion filmi**

Fokusi i këtij grupi pune është promovimi i Tiranës si një destinacion atraktiv për prodhimin ndërkombëtar të filmit. I përbërë nga ekspertë me përvojë të industrisë, ky grup synon të identifikojë hapat e nevojshëm për të promovuar përzierjen unike të sharmit historik dhe gjallërisë bashkëkohore të Tiranës, duke e pozicionuar atë si një sfond ideal për projekte të ndryshme filmike. Qëllimi i këtij grupi do të jetë identifikimi i nismave strategjike, sistemeve të nevojshme të mbështetjes logjistike dhe programeve arsimore për të promovuar Tiranën si një mjedis tërheqës dhe me kosto efektive për kineastët në mbarë botën.

Moderator: Genc Përmeti

Ekspert: Eno Milkani

Dritan Huqi

Elkjana Gjipali

Sabina Kodra

Julian Wall (Soulful Films UK)

Jonathan English (Balkan Media)

- Ora 14: 30 -15:30- Dreka
- Ora 15: 30 UK Creative Economy Overview - John Newbigin
- Ora 16:00 – 16:30 British Council Creative Economy programme - Rehana Mughal
- Ora 16:30 – 19:00 Guidë turistike Tiranë
- Ora 19:30 Darka

Dita 2 - 29 Janar 2024

Vendodhja: Piramida

- Ora 10:00 – 11:00 **Prezantime dhe rekomandimet e grupeve të punës**

Moderatore: Clare Sears

10:00 – 10:15 Infrastruktura e re kulturore

10:15 – 10:30 City Branding - Integrimi i identiteteve të reja në markën e qytetit

10:30 – 10:45 Eventet e mëdha kulturore dhe ndikimi i tyre në qytet

10:45 – 11:00 Qyteti si destinacion filmi

➤ 11:00 – 12:00 **Axhenda e përbashkët në sektorin krijues**

Në të kaluarën, ndryshimet në politika dhe praktika kanë ndodhur kur disiplina të ndryshme në sektorin krijues kanë vepruar së bashku. Në këtë seancë pjesëmarrësit e konferencës do të marrin pjesë në një diskutim të përbashkët dhe do të përdorin rekomandimet e grupeve të punës si pikënisje. Qëllimi i këtij ushtrimi është të përcaktojë pesë kërkesat kryesore të përbashkëta ndaj politikëbërësve.

➤ 12.15 – 13.00 Rekomandime, komente dhe përfundime

Moderator: John Newbiggin

Fjala përmbyllëse: Shkëlqesia e Tij z. Alastair King-Smith, Ambadori Britanik në Shqipëri

➤ 13.00 **Festë përmbyllëse**